

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA-GOVERNMENT MINISTRIA E PUNES DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite-Ministry of Labour and Social Welfare Sektor i Arkivit-Sektor Archive-Archive Sector	
Niviu Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: 102
No. fytëve Broj stranica No pages: 02	Data: Datum: Date: 02.03.2018
Prishtinë-Prishtina-Prishtina	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**  
**Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare**

Datë: 22.02.2018

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës ( Gazeta Zyrtare nr.82, dt.21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe shtojcën 10 të Rregullore Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe Rregulloren Nr.14/2017 dhe Rregullores 15/2017, me Rregullore nr.16/2017, Udhëzimi Administrativ nr.06/2017, për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2012, për organizmin, fushëveprimin dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe listës përfundimtare nga regjistri i profesionistëve dhe të anëtarëve të emëruar nga Institucionet e mendatuara me Ligj sipas Komisioni vlerësues, nxjerr;

**VENDIM**

1. Themelohet Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare nga regjistri i profesionistëve dhe të anëtarëve të emëruar nga Institucionet e mandatuar me ligj.

2. Këshilli sipas pikës një (1) të këtij vendimi është në këtë përbërje;

- 2.1. Kimete Kryeziu.....Qendra për Punë Sociale/ Kamenicë;
- 2.2. Ibrahim Gashi.....Qendra për Punë Sociale/ Dragash;
- 2.3. Zoran Risic.....Qendra për Punë Sociale/ Ranilug;
- 2.4. Shyqeri Mehmeti.....Qendra për Punë Sociale/ Ferizaj;
- 2.5. Isak Zogjani.....Qendra për Punë Sociale/ F. Kosovë;
- 2.6. Muharrem Kika.....Qendra për Punë Sociale/ Prishtinë;
- 2.7. Sami Rrakaqi.....Qendra për Punë Sociale/ Suharekë;
- 2.8. Enver Berisha.....Qendra për Punë Sociale/ Suharekë;
- 2.9. Xhuljeta Humolli.....Qendra e Shëndetit Mendor/ Prishtinë;
- 2.10. Bilbil Oruçi.....Qendra për Punë Sociale/ Rahovec;
- 2.11. Ylfete Ramosaj-Abazi..... Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 2.12. Bajram Kelmendi.....Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 2.13. Magbule Koci.....Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 2.14. Fehmi Ibrahimimi .....Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

- 2.15. Hidajete Vokshi.....Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;  
2.16. Kadrije Sopjani-Retkoceri.....Ministria e Shëndetësisë;  
2.17. Besnik Berisha.....Asociacioni i Komunave të Kosovës;  
2.18. Petrit Loci.....Asociacioni i Komunave të Kosovës;  
2.19. Lulzim Dragidella.....Universiteti i Prishtinës;  
2.20. Dashamir Bërxulli.....Universiteti i Prishtinës;  
2.21. Anita Rashiti-Fazliu.....Organizata Joqeveritare.

3. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KPSHSF-së është katër (4) vjet, me mundësi të rí-zgjedhjes edhe për një mandat.

4. Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare të përcaktuara në Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, dhe me Ligjin nr. 04/l-081 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/l-17 për shërbime sociale dhe familjare.

5. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale gjatë aktivitetit të tyre në Këshill, duhet të jene të pavarur dhe të paanshëm, duke mos qenë të ndikuar nga asnjë grup i interesi në ushtrimin funksionit të tyre.

6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale, mund të ndërmarr masa disiplinore dhe ligjore ndaj atyre anëtarëve të Këshillit, të cilët bëjnë shkelje apo nuk i përmbushin detyrimet e tyre të parapara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale, për angazhimet e tyre në këtë organ si dhe për pjesëmarrjen në seanca/komisione të Këshillit, do të kompensohen në bazë akteve nënligjore të Këshillit.

8. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht Departamenti përkatës, duhet të sigurojë kushte të punës për funksionimin e drejtë dhe ligjor të Këshillit, ndërsa për mbështetjet teknike dhe administrativ për funksionimin e drejte dhe efikas të këshillit do të mbështetet nga Sekretaria e Këshillit.

9. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Skender Reçica

Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit,
- Zyrës së Ministrit,
- Zyre së Sekretari të Përgjithshëm
- Sekretarisë së Këshillit, dhe
- Arkivit të MPMS-së

Faqe 2 nga 2